

Modeli i Klauzolës së Arbitrazhit:

Qendra ZAK e Odës Amerikane u rekomandon palëve, të cilat dëshirojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet bazuar në Rregullat e Arbitrazhit të Odës Amerikane, të përdorni klauzolën e mëposhtme në kontratat e tyre:

“Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo është në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, do të zgjidhet me arbitrazh në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.”

Palët duhet që gjithashtu të konsiderojnë:

- (a) Autoriteti i emërimit duhet të jetë ... [emri i institucionit ose personit];
- (b) Numri i arbitrave do të jetë... [një ose tre];
- (c) Vendi i arbitrazhit do të jetë ... [qyteti dhe vendi];
- (d) Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë [gjuha];
- (e) Ligji i aplikueshëm i të drejtës materiale është

Model Arbitration Clause:

AmCham ADR Center recommends parties, desiring to resolve their disputes under the AmCham's Arbitration Rules, to include the below-stated arbitration clause in their agreements:

“Any dispute, controversy or claim arising out of or in relation to this contract, including the validity, invalidity, breach or termination thereof, shall be resolved by arbitration administered by the American Chamber of Commerce in Kosovo in accordance with the Rules of Arbitration of the American Chamber of Commerce in Kosovo.”

Parties should also consider:

- (a) The appointing authority shall be... [name of the institution or person];
- (b) The number of arbitrators/mediators shall be... [one or three for arbitrators];
- (c) The place of the arbitration/mediation shall be ... [city and or country];
- (d) The arbitral proceedings shall be conducted in---- [language];
- (e) The applicable law is

Rregullat e arbitrazhit 2011

Vendim mbi caktimin e tarifave mbi shpenzimet e procedurës së arbitrazhit

Ligji për arbitrazhin

Rregullat e arbitrazhit

2011



Rregullat e Arbitrazhit 2011

I. RREGULLAT HYRËSE	5
II. Përbërja e tribunalit të arbitrazhi	6
III. Procedura e arbitrazhit.....	10
IV. Vendimi.....	16
V. Konfidencialiteti.....	18
VI. Procedura e përshpejtuar.....	18
VII. Kompetencat gjatë procedurës.....	19
Shtojcë.....	20



Rregullat hyrëse Fusha e zbatimit

Neni 1

1. Këto rregulla do të udhëheqin arbitrazhin vendor dhe ndërkombëtar të mosmarrëveshjeve në lidhje me një marrëdhënie të përcaktuar ligjore, kontraktuese apo jokontraktuese, ku një marrëveshje i referohet arbitrazhit sipas këtyre Rregullave në kuadër të Qendrës për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ZAK) pranë Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Në tekstin e mëposhtëm, Qendra ZAK, do të referohet si një „institution arbitrazhi“.
2. Këto rregulla zbatohen në përputhje me modifikime të tilla të dakorduara nga palët.
3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, këto rregulla do të zbatohen për të gjithë procedurat e arbitrazhit, në të cilat padia paraqitet në ose pas datës së hyrjes në fuqi të këtyre Rregullave.
4. Këto rregulla do të udhëheqin arbitrazhin, përveç se kur ndonjëra nga këto rregulla është në kundërshtim me një dispozitë të ligjit në fuqi për arbitrazhin nga të cilat palët nuk mund të dërgojnë, ajo dispozitë do të mbizotërojë.

Njoftimi dhe llogaritja e periudhave të kohës

Neni 2

1. Një lajmërim, duke përfshirë një njoftim, komunikim apo propozim, mund të transmetohet me çdo mjet të komunikimit që ofron ose lejon për një regjistrim të transmetimit të tij.
2. Nëse një adresë është caktuar nga një palë posaçërisht për këtë qëllim ose është autorizuar nga tribunali i arbitrazhit, çdo njoftim do të dorëzohet palës në atë adresë, dhe nëse i dorëzuar në këtë mënyrë, konsiderohet se ka qenë i pranuar. Dorëzimi me anë të mjeteve elektronike të tilla si faksimili ose posta elektronike mund të bëhet vetëm në një adresë e caktuar ose e autorizuar për këtë.
3. Në mungesë të përcaktimit ose autorizimit të tillë, një njoftim është:
 - (a) pranuar në qoftë se ai i është dorëzuar fizikisht të adresuarit; ose
 - (b) konsiderohet se është pranuar nëse ai është dorëzuar në vendin e biznesit, vendbanimin ose në adresën postare të adresuarit.
4. Nëse, pas përpjekjeve të arsyeshme, dorëzimi nuk mund të kryhet në përputhje me paragrafët 2 ose 3, një njoftim konsiderohet se është pranuar nëse ai është dërguar në vendin e fundit të njohur të biznesit të adresuarit, vendbanimin ose adresën postare, me letër të regjistruar ose ndonjë mjet tjetër që ofron një regjistrim të dorëzimit apo tentimit të dorëzimit.
5. Një njoftim do të konsiderohet se është pranuar në ditën kur është dorëzuar në përputhje me paragrafët 2, 3 ose 4, ose është tentuar të dorëzohet në pajtim me paragrafin 4. Një njoftim që transmetohet nga mjetet elektronike konsiderohet të ketë qenë pranuar në ditën kur është dërguar, përveç nëse një njoftim i arbitrazhit i transmetuar në këtë mënyrë mendohet se është pranuar vetëm në ditën kur ai arrin në adresën elektronike të adresuarit.
6. Për qëllime të llogaritjes së periudhës kohore sipas këtyre rregullave, periudha e tillë do të fillojë të rrjedhë në ditën pas ditës së pranimit të njoftimit. Nëse dita e fundit e një periudhe të tillë është një festë zyrtare ose një ditë pushimi në vendbanimin ose vendin e biznesit të adresuarit, periudha zgjatet deri në ditën e parë të punës që vijon. Festat zyrtare ose ditët e pushimit që ndodhin gjatë periudhës kohore, përfshihen në llogaritjen e periudhës.

Përfaqësimi dhe ndihma

Neni 3

Secila palë mund të përfaqësohet ose ndihmohet nga persona të zgjedhur prej saj. Emrat dhe adresat e personave të tillë duhet t'i komunikohen të gjitha palëve dhe tribunalit të arbitrazhit. Një komunikim i tillë duhet të specifikojë nëse emërimi është duke u bërë për qëllime të përfaqësimit apo të ndihmës. Kur një person do të veprojë si një përfaqësues i një pale, tribunali i arbitrazhit, me iniciativën e vet ose me kërkesën e ndonjë pale, në çdo kohë mund të kërkojë autorizimin e dhënë për përfaqësuesin në një formë të tillë si përcaktohet nga tribunali i arbitrazhit.

Përcaktimi i autoriteteve të emërimit

Neni 4

Nëse palët kanë rënë dakord për zgjedhjen e një autoriteti të emërimit, autoriteti i emërimit do të jetë organ i caktuar si i tillë sipas rregullave organizative të institucionit arbitrazhit.

Përbërja e tribunalit të arbitrazhit Numri i arbitërve

Neni 5

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord më parë për numrin e arbitërve, autoriteti i emërimit do të vendosë nëse çështja do t'i referohet një arbitëri të vetëm ose në një tribunal arbitrazhi prej tre anëtarëve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante.
2. Si rregull, autoriteti i emërimit do ta referojë rastin një arbitëri të vetëm, përveç nëse ndërlikueshmëria e lëndës dhe / ose shuma në mosmarrëveshje arsyeton që rasti t'i referohet një tribunalit të arbitrazhit prej tre anëtarëve.
3. Për qëllime të këtyre Rregullave, shprehja "tribunal i arbitrazhit" përfshinë një arbitër të vetëm apo tribunalin e arbitrazhit nga tre anëtarë.

Emërimi i arbitrave (neni 6 deri 9)

Neni 6

1. Palët mund të emërojnë arbitërat që janë në listën e institucionit të arbitrazhit.
2. Palët mund po ashtu si arbitëra të emërojnë persona të cilët nuk janë në listën e tillë të arbitërve, me kusht që ai person siguron një deklaratë të shkurtër rreth së kaluarës së tij dhe përvojën e tashme profesionale. Kjo deklaratë duhet të sigurohet nëse arbitëri emërohet nga ndonjë autoritet emërues që është tjetër nga autoriteti i përcaktuar emërues nga institucioni i arbitrazhit.
3. Emërimi i arbitërit do të bëhet efektiv, kur kjo konfirmohet nga institucioni i arbitrazhit në pajtim me nenin 12 të këtyre Rregullave. Sipas kësaj, çdo referencë për emërim sipas këtyre Rregullave konsiderohet si nominim gjersa të konfirmohet nga institucioni i arbitrazhit.

Neni 7

1. Në qoftë se palët kanë rënë dakord që të emërohet një arbitër i vetëm dhe në qoftë se brenda 30 ditëve pas pranimit nga të gjitha palët tjera të një propozimi për emërimin e arbitërit të vetëm palët nuk kanë arritur marrëveshje, një arbitër i vetëm do të emërohet nga autoriteti i emërimit.

2. Autoriteti i emërimit do ta emërojë arbitërin e vetëm sa më shpejt të jetë e mundur. Gjatë emërimit, autoriteti i emërimit do të përdorë listë - procedurën e mëposhtme, përveç nëse palët pajtohen se listë - procedura nuk duhet të përdoret apo nëse autoriteti i emërimit përcakton në diskrecionin e tij se përdorimi i listë - procedurës nuk është i përshtatshëm për atë rast:

(a) Autoriteti i emërimit do t'i komunikojë secilës nga palët një listë të njëjtë që përmban të paktën tre emra;
 (b) Brenda 15 ditëve pas marrjes së kësaj liste, secila palë mund të kthejë listën autoritetit të emërimit pasi ka fshirë emrin ose emrat e të cilat i kundërshton dhe duke i numëruar emrat e mbetura në listë në renditje sipas preferencës;

(c) Pas skadimit të afatit kohor të mësipërm, autoriteti i emërimit e emëron arbitërin e vetëm nga radhët e emrave të miratuar në listat e kthyer dhe në përputhje me renditjen e preferencës treguar nga palët;

(d) Nëse për ndonjë arsye emërimi nuk mund të bëhet sipas kësaj procedure, autoriteti i emërimit mund të ushtrojë diskrecionin e tij në emërimin e arbitërit të vetëm.

Neni 8

1. Nëse duhet të emërohen tre arbitëra, secila palë emëron një arbitër. Të dy arbitërat e emëruar në këtë mënyrë do të zgjedhin arbitërin e tretë i cili do të veprojë si arbitër kryesues i tribunalit të arbitrazhit.

2. Nëse brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga pala për emërimin e një arbitëri pala tjetër nuk e ka njoftuar palën e parë për arbitërin të cilin e ka emëruar, pala e parë mund të kërkojë nga autoriteti i emërimit të emërojë arbitërin të dytë.

3. Nëse brenda 30 ditëve pas emërimit të arbitërit të dytë të dy arbitërat nuk kanë rënë dakord për zgjedhjen e arbitërit kryesues, arbitëri kryesues do të emërohet nga autoriteti i emërimit në të njëjtën mënyrë si emërohet një arbitër i vetëm sipas nenit 7.

Neni 9

1. Për qëllime të nenit 8, paragrafi 1, ku tre arbitëra duhet të emërohen dhe ka palë të shumta si paditës ose si të paditur, përveç nëse palët janë pajtuar për një tjetër metodë të emërimit të arbitërve, palët e shumta së bashku, qoftë si paditës apo si të paditur, do të emërojnë një arbitër.

2. Në rast të çdo dështimi për të formuar tribunalin e arbitrazhit sipas këtyre rregullave, autoriteti i emërimit, me kërkesën e ndonjë pale, do të formojë tribunalin e arbitrazhit dhe, duke bërë kështu, mund të revokojë çdo emërim tashmë të bërë dhe të emërojë ose të riemërojë secilin prej arbitërve dhe të caktojë njërin prej tyre si arbitër kryesues.

Pranimi i mandatit të arbitërit dhe zbulimi i informacioneve

Neni 10

1. Çdo arbitër duhet të jetë dhe të mbetet i pavarur nga palët e përfshira në arbitrazh.

2. Çdo person që kontaktohet në lidhje me emërimin e tij apo të saj si një arbitër, pa vonesë të paarsyeshme njofton institucionin e arbitrazhit për pranimin e emërimit si arbitër dhe deklaron nëse plotëson kushtet e dakorduara nga palët. Ai ose ajo do të zbulojë të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë dyshime të arsyeshme për paanshmërinë ose pavarësinë e tij ose të saj. Institucioni i arbitrazhit njofton palët lidhur me këtë.

3. Nëse rrethanat janë evidente nga deklarata e arbitërit, të cilat kanë gjasë që të shfaqin dyshime në lidhje me paanshmërinë apo pavarësinë e tij apo në lidhje me përmbushjen e kualifikimeve të dakorduara, institucioni i arbitrazhit i jep palëve mundësinë që të komentojë brenda afatit përkatës.

4. Një arbitër, nga koha e emërimit të tij ose të saj dhe gjatë të gjithë procedurës së arbitrazhit, duhet pa vonesë të zbulojë rrethanat e tilla palëve dhe arbitrave të tjerë, përveç nëse ata tashmë janë informuar nga ai apo ajo rreth këtyre rrethanave.

Konfirmimi i arbitërit

Neni 11

1. Institucioni i arbitrazhit mund të konfirmojë arbitërin e propozuar menjëherë kur institucioni i arbitrazhit pranon deklaratën e arbitërit me të cilën deklaron pranimin, dhe nëse nga deklarata nuk janë evidente rrethanat që shfaqin dyshim në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e arbitërit apo përmbushjen e kualifikimeve të dakorduara, apo nëse brenda afatit kohor të përcaktuar nga Neni 13.1 asnjë palë nuk kundërshton konfirmimin e atij arbitri.
2. Në rast të kërkesës për përjashtim sipas nenit 13.1, ku njëra palë zgjedh që të bëjë kërkojë përjashtimin në bazë të dispozitës 13.4, vendimi nga institucioni i arbitrazhit për të refuzuar përjashtimin e arbitrit të propozuar konsiderohet si konfirmim i atij arbitëri.
3. Me konfirmimin e të gjithë arbitërave, konstituohet tribunali i arbitrazhit. Institucioni i arbitrazhit njofton palët për konstituimin e tribunalit të arbitrazhit.

Përjashtimi i arbitërave (nenet 12 gjer 14)

Neni 12

1. Çdo arbitër mund të përjashtohet në qoftë se ekzistojnë rrethana të cilat sjellin dyshime të arsyeshme për paanësinë ose pavarësinë e arbitërit.
2. Një palë mund të përjashtojë arbitërin e emëruar prej saj vetëm për arsytet për të cilat pala njoftohet pas emërimit.
3. Në rast se një arbitër nuk vepron, ose në rast të pamundësisë de jure ose de facto të tij ose të saj për të kryer funksionin e arbitrit, zbatohet procedura e përjashtimit të arbitërit, siç parashihet në nenin 13.

Neni 13

1. Një palë që kërkon të përjashtojë një arbitër do të dërgojë njoftimin për përjashtim brenda 15 ditëve pasi ajo ka qenë njoftuar për emërimin e arbitërit që dëshiron të përjashtohet, ose brenda 15 ditëve pasi që pala njoftohet mbi rrethanat e përmendura në nenet 11 dhe 12.
2. Njoftimi mbi përjashtimin do t'i komunikohet të gjithë palëve tjera, arbitërit i cili pretendohet të përjashtohet, arbitërave tjerë dhe institucionit të arbitrazhit. Njoftimi mbi përjashtimin duhet të përmbajë arsytet për përjashtim.
3. Kur një arbitër kërkohet të përjashtohet nga një palë, të gjitha palët mund të pajtohen me atë kërkesë. Arbitëri mund po ashtu, pas kërkesës për përjashtim, të tërhiqet nga detyra e tij apo e saj. Në asnjë rast kjo nuk nënkupton pranimin e vlefshmërisë së arsyeve të përjashtimit.
4. Nëse, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të përjashtimit, të gjitha palët nuk pajtohen për përjashtimin ose arbitri nuk tërhiqet, pala e cila paraqet kërkesën për përjashtim mund të zgjedhë për të vazhduar dhe kërkon vendimin për përjashtimin nga institucioni i arbitrazhit. Në këtë rast, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit nga pala që kërkon përjashtimin, pala tjetër dhe arbitëri i përjashtuar dorëzon përgjigjen ndaj përjashtimit.
5. Institucioni i arbitrazhit merr vendimin për përjashtim pa vonesë të paarsyeshme. Ky vendim është i formës së prerë.

Zëvendësimi i arbitërit

Neni 14

1. Në pajtim me paragrafin 2, në çdo rast kur një arbitër duhet të zëvendësohet gjatë rrjedhës së procedurës së arbitrazhit, një arbitër zëvendësues do të emërohet apo të zgjidhet në pajtim me procedurën e parashikuar në nenet 7 deri 11 që është zbatuar për emërimin ose zgjedhjen e arbitërit që zëvendësohet. Kjo procedurë do të zbatohet edhe në qoftë se gjatë procesit të emërimit të arbitrit që duhet zëvendësuar, një palë nuk ka ushtruar të drejtën e saj për të emëruar ose për të marrë pjesë në takim.

2. Në qoftë se, me kërkesë të një pale, autoriteti i emërimit përcakton se, në pikëpamje të rrethanave të jashtëzakonshme të rastit, do të ishte e justifikuar për një palë të jetë e privuar nga e drejta e saj për të emëruar një arbitër zëvendësues, autoriteti i emërimit mundet, pasi i ka dhënë një mundësi palëve dhe arbitërave të mbetur të shprehin pikëpamjet e tyre: (a) të emërojë arbitrin zëvendësues, ose (b) pas mbylljes së seancave, të autorizojë arbitërat tjerë të vazhdojnë me procedurat e arbitrazhit dhe të marrin cilindo vendim.

Përsëritja e seancave dëgjimore në rast të zëvendësimit të një arbitëri

Neni 15

Në qoftë se një arbitër është zëvendësuar, procedura do të vazhdojë në fazën ku arbitëri i cili u zëvendësua ka pushuar së kryeri funksionet e tij apo të saj, përveç nëse tribunali i arbitrazhit nuk vendos ndryshe.

Përfundimi i detyrimit

Neni 16

Përveç për shkelje të qëllimshme, palët heqin dorë, në masën e plotë të lejuar sipas ligjit në fuqi, nga çdo pretendim kundër arbitërve, autoritetit emërues, institucioni i arbitrazhit dhe çdo personi të emëruar nga tribunali i arbitrazhit bazuar në ndonjë veprim apo mosveprim në lidhje me procedurat e arbitrazhit.

Procedura e arbitrazhit Dispozitat e përgjithshme

Neni 17

1. Në pajtim me këto rregulla, tribunali i arbitrazhit mund të udhëheqë arbitrazhin në mënyrë të tillë që e konsideron si të përshtatshme, me kusht që palët të trajtohen me barazi dhe që në një fazë të përshtatshme të procedurës secilës palë i është dhënë një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj. Tribunali i arbitrazhit, në ushtrimin e diskrecionit të tij, do të udhëheqë procedurën në mënyrë që të shmangen vonesat dhe shpenzimet e panevojshme dhe të sigurohet një proces i drejtë dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së palëve.

2. Sa më shpejt të jetë e mundur pas formimit të tij dhe pasi të jenë ftuar palët të shprehin pikëpamjet e tyre, tribunali i arbitrazhit do të përcaktojë orarin e përkohshëm të arbitrazhit, i cili do ti jepet palëve dhe, për informacion, institucionit të arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit mundet, në çdo kohë, pasi të ketë ftuar palët të shprehin pikëpamjet e tyre, të zgjas ose të shkurtojë çdo periudhë kohore të përcaktuar në bazë të këtyre rregullave apo të rënë dakord nga palët. Tribunali i arbitrazhit siguron orarin e rishikuar të institucionit të arbitrazhit.

3. Në qoftë se në një fazë të përshtatshme të procedurës ndonjë palë e kërkon këtë, tribunali i arbitrazhit do të mbajë seanca për paraqitjen e provave nga dëshmitarët, duke përfshirë edhe dëshmitarë ekspertë, apo për argumente me gojë. Në mungesë të një kërkesë të tillë, tribunali i arbitrazhit do të vendosë nëse do të zhvillojë seanca të tilla ose nëse procedura do të udhëhiqet në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera.

4. Të gjitha komunikimet me tribunalin e arbitrazhit nga njëra palë do t'i komunikohen, nga ajo palë, të gjitha palëve të tjera dhe institucionit të arbitrazhit. Komunikimet e tilla do të bëhen në të njëjtën kohë, përveç kur lejohet ndryshe nga tribunali i arbitrazhit në bazë të ligjit në fuqi.

5. Tribunali i arbitrazhit mundet, me kërkesën e ndonjë pale, ti lejojë një ose më shumë personave të tretë ti bashkohen arbitrazhit si palë, me kusht që personi i tillë është palë në marrëveshjen e arbitrazhit, përveç nëse tribunali i arbitrazhit konstaton, pasi që i jep të gjitha palëve, duke përfshirë personin ose personat që mund të bashkohen, mundësinë për t'u dëgjuar, që bashkimi nuk duhet të lejohet për shkak të paragjykimeve të ndonjë prej këtyre palëve. Tribunali i arbitrazhit mund të merr një vendim të vetëm apo disa vendime në lidhje me të gjitha palët e përfshira në arbitrazh.

Vendi i arbitrazhit

Neni 18

1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord më parë për vendin e arbitrazhit, ose në qoftë se përcaktimi i tillë është i paqartë ose jo i plotë, vendi i arbitrazhit do të Kosova përveç nëse institucioni i arbitrazhit duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe pasi që palëve iu jep mundësinë për të bërë komente me shkrim, vendosë se ndonjë seli tjetër është më përkatëse. Vendimi do të konsiderohet se është marrë në vendin e arbitrazhit.

2. Tribunali i arbitrazhit mund të takohet në cilindo vend që e konsideron të përshtatshëm për shqyrtim. Përveç nëse palët nuk pajtohen ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të takohet gjithashtu në çdo vend që e konsideron të përshtatshëm për ndonjë qëllim tjetër, duke përfshirë edhe seancat dëgjimore. Në çdo rast, tribunali i arbitrazhit duhet të njoftojë institucionin e arbitrazhit për vendet e tilla dhe, në qoftë se palët pritet të jenë të pranishme, ti jepet lajmërim i mjaftueshëm kohor.

Gjuha

Neni 19

1. Në pajtim me marrëveshjen nga palët, tribunali i arbitrazhit, menjëherë pas formimit të tij, do të përcaktojë gjuhën ose gjuhët që do të përdoren gjatë procedurës. Ky përcaktim do të zbatohet për padinë, deklaratën e mbrojtjes, dhe çdo deklaratë tjetër me shkrim dhe, në qoftë se mbahen seancat dëgjimore, për gjuhën ose gjuhët që do të përdoret në seancat e tilla.
2. Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që të gjitha dokumentet e bashkëngjitura në padi apo deklarata e mbrojtjes, dhe të gjitha dokumentet plotësuese apo provat materiale të dorëzuara gjatë procedurës, të dorëzuara në gjuhën e tyre origjinale, të shoqërohen nga një përkthim në gjuhën apo gjuhët e rënë dakord nga palët, ose të përcaktuar nga tribunali i arbitrazhit.
3. Deri në përcaktimin e gjuhës së procedurës, një padi, një mbrojtje dhe dokumentet e tjera mund të paraqiten në gjuhën e kontratës kryesore, marrëveshjes së arbitrazhit ose në çdo gjuhë në përdorim zyrtar në selinë e institucionit të arbitrazhit.
4. Nëse as palët dhe as arbitrat nuk mund të arrijnë një marrëveshje për gjuhën e arbitrazhit, gjuha e arbitrazhit do të përcaktohet nga institucioni arbitrazhit.

Padia

Neni 20

1. Padiësi duhet të komunikojë padinë e tij me shkrim institucionit të arbitrazhit. Procedura fillon kur të pranohet padia nga ana e institucionit të arbitrazhit. Institucioni i arbitrazhit dërgon padinë te i padituri pa vonesë të paarsyeshme.
2. Përveç nëse palët vijnë në një marrëveshje të ndryshme, padia përfshin njoftimin e arbitrazhit.
3. Padiësi duhet të dorëzojë një kopje të padisë së shtojcat për secilin të paditur, secilin arbitër dhe institucionin e arbitrazhit.
4. Padia në veçanti duhet të përfshijë të dhënat e mëposhtme:
 - (a) Emrat dhe detajet e kontaktit të palëve;
 - (b) Identifikimin e marrëveshjes së arbitrazhit në të cilën thirret;
 - (c) Një përshkrim të shkurtër të mosmarrëveshjes;
 - (d) Faktet në mbështetje të padisë;
 - (e) Pikat kryesore në çështje;
 - (f) Mjetet juridike të kërkuara;
 - (g) Bazën ligjore apo argumentet në mbështetje të padisë;
 - (h) Shumën në mosmarrëveshje në kohën e paraqitjes së padisë, përveç nëse padia nuk është e lidhura me një shumë të caktuar parash;
 - (i) Propozimin për numrin e arbitrave, gjuhën, vendin e arbitrazhit, nëse palët nuk kanë rënë dakord më parë për këto.
 - (j) Në qoftë se kërkohet një vendim nga tre arbitra, emërimin e një arbitri dhe detajet e kontaktit të atij personi dhe hollësitë e kontaktimit të atij personi.
 - (k) Në qoftë se emërohet një arbitër i vetëm, propozimi në lidhje me arbitrin për t'u emëruar.
5. Padiësi duhet bashkëngjitur një kopje të ndonjë kontrate apo instrumenti tjetër ligjor nga e cila ose në lidhje me të cilën lind mosmarrëveshja ai dhe kopjen e marrëveshjes së arbitrazhit.
6. Padia duhet, për aq sa është e mundur, të jetë e shoqëruar nga të gjitha dokumentet dhe provat e tjera në të cilat mbështetet padiësi, apo të përmbajnë referenca për to.

Deklarata e mbrojtjes

Neni 21

1. I padituri do të komunikojë deklaratën e tij të mbrojtjes me shkrim institucionit të arbitrazhit, brenda një periudhe kohore që do të përcaktohet nga institucioni i arbitrazhit.
2. Deklarata e mbrojtjes do të përgjigjet për të dhënat (b) deri në (k) padisë (neni 20, paragrafi 4). Deklarata e mbrojtjes duhet, për aq sa është e mundur, të jetë e shoqëruar nga të gjitha dokumentet dhe provat e tjera në të cilat mbështetet i padituri, apo të përmbajnë referenca për to.
3. Në deklaratën e tij të mbrojtjes, apo në një fazë të mëvonshme në procedurën e arbitrazhit, nëse tribunali i arbitrazhit vendos se vonesa ishte e justifikuar nga rrethanat, i padituri mund të bëjë një kundërpadi ose të mbështetet në padi me qëllim të kompensimit të ndërsjellë, me kusht që tribunali i arbitrazhit ka juridiksion mbi këtë.
4. Dispozitat e nenit 20, paragrafët 3 deri në 6, do të zbatohen për kundërpadinë, dhe mbështetjen në padinë me qëllim të kompensimit të ndërsjellë.

Ndryshimet në padi ose mbrojtje

Neni 22

Gjatë rrjedhës së procedurës së arbitrazhit, pala mund ta ndryshojë ose ta plotësojë padinë ose mbrojtjen e vet, duke përfshirë kundërpadinë ose padinë për qëllimin e kompensimit të ndërsjellë, përveç nëse tribunali i arbitrazhit e konsideron të papërshtatshme për të lejuar një ndryshim ose plotësim të tillë duke pasur parasysh vonesën në bërje apo paragjykimin për palët e tjera ose ndonjë rrethane tjetër. Megjithatë, një padi apo mbrojtje, duke përfshirë kundërpadinë ose padinë për qëllimin e kompensimit të ndërsjellë, nuk mund të ndryshohet ose të plotësohet në mënyrë të tillë që padia e ndryshuar ose e plotësuar ose mbrojtja bie jashtë juridiksionit të tribunalit të arbitrazhit.

Përcjellja e shkresave të lëndës në tribunalin e arbitrazhit

Neni 23

Institucioni i arbitrazhit do të përcjell padinë dhe mbrojtjen si dhe dokumentet e tjera anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit menjëherë pasi që padia ose kundërpadia janë pranuar në formë të duhur, arbitrat kanë konfirmuar pranimin e mandatit të tyre dhe objektivitetin e tyre, dhe depozita për shpenzimet është paguar.

Pretendimet në lidhje me juridiksionin e tribunalit të arbitrazhit

Neni 24

1. Tribunali i arbitrazhit do të ketë kompetencën për të vendosur për juridiksionin e vet, duke përfshirë edhe ndonjë kundërshtim në lidhje me ekzistencën ose vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. Për këtë qëllim, një klauzolë arbitrazhi që është pjesë e një kontrate do të trajtohet si një marrëveshje e pavarur nga kushtet tjera të kontratës. Një vendim nga tribunali i arbitrazhit se kontrata është e pavlefshme nuk do të sjellë automatikisht pavlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit.
2. Pretendimi që tribunali i arbitrazhit nuk ka juridiksion do të ngritët jo më vonë se në deklaratën e mbrojtjes ose, në lidhje me një kundërpadi ose një padi për qëllimin e kompensimit të ndërsjellë, në përgjigje të kundërpadisë ose padisë për qëllimin e kompensimit të ndërsjellë. Një palë nuk pengohet nga ngritja e pretendimit të tillë nga fakti se ka emëruar, ose ka marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Një pretendim që tribunali i arbitrazhit është duke e tejkaluar fushëveprimin e autoritetit të tij do të ngritët menjëherë pasi që çështja për të cilën konsiderohet të jetë përtej fushëveprimit të autoritetit të tribunalit është ngritur gjatë procedurës së arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit mundet, në secilin rast, të pranojë një pretendim të vonshëm, nëse mendon se vonesa është e justifikuar.

3. Tribunali i arbitrazhit mund të vendosë mbi pretendimin nga paragrafi 2 ose si një pyetje paraprake ose në vendimin mbi meritat. Tribunali i arbitrazhit mund të vazhdojë procedurën e arbitrazhit dhe të merr një vendim, pa marrë parasysh kundërshtimeve në lidhje me juridiksionin e tij para një gjykatë.

Deklarata tjera me shkrim

Neni 25

Tribunali i arbitrazhit do të vendosë se cilat deklaratat tjera me shkrim, përveç padisë dhe deklaratës së mbrojtjes, do të kërkohen nga palët apo mund të paraqiten nga ana e tyre dhe do të caktojë afatet kohore për paraqitjen e deklaratave të tilla.

Afatet kohore

Neni 26

Afatet kohore të caktuara nga tribunali i arbitrazhit për paraqitjen e deklaratave me shkrim (duke përfshirë edhe padinë dhe deklaratën e mbrojtjes) nuk duhet të kalojnë 45 ditë. Megjithatë, tribunali i arbitrazhit mund të zgjasë afatet nëse konstaton se një zgjatje është e justifikuar.

Masat e përkohshme

Neni 27

1. Tribunali i arbitrazhit mundet, me kërkesën e një pale, të caktojë masat e përkohshme.
2. Një masë e përkohshme është çdo masë e përkohshme me të cilën, në çdo kohë para nxjerrjes së vendimit përfundimtar mbi mosmarrëveshjen, tribunali i arbitrazhit urdhëron një palë, për shembull dhe pa kufizim, të:
 - (a) mbajë ose të rivendosë status quo në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes;
 - (b) ndërmerr veprime që mund të parandalojnë, ose të përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve që mund të shkaktojnë, (i) dëme të tanishme apo të ardhshme, ose (ii) të cenojnë procesin e arbitrazhit;
 - (c) siguron një mjet për ruajtjen e pasurive nga të cilat një vendim i mëvonshëm mund të përmbushet; ose
 - (d) ruajë provat që mund të jenë relevante dhe materiale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
3. Pala që kërkon një masë të përkohshme sipas paragrafit 2 (a) deri në (c) do të demonstrojë tribunalit të arbitrazhit që:
 - (a) nëse nuk caktohet masa e përkohshme do të shkaktohet dëmi i cili nuk mund të riparohet në mënyrë adekuate, dhe dëmi i tillë në mënyrë thelbësore tejkalon dëmin që mund ti shkaktohet palës ndaj të cilës masa e përkohshme, nëse caktohet, është e drejtuar; dhe
 - (b) ka një mundësi të arsyeshme që pala kërkuuese do të ketë sukses për meritat e kërkesës. Përcaktimi në këtë mundësi nuk do të ndikoj në diskrecionin e tribunalit të arbitrazhit në përcaktimet e mëvonshme.
4. Në lidhje me një kërkesë për masë të përkohshme sipas paragrafit 2 (d), kërkesat në paragrafët 3 (a) dhe (b) do të zbatohen vetëm në masën që tribunali i arbitrazhit e konsideron të përshtatshme.
5. Tribunali i arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose të ndërpresë një masë të përkohshme që ka dhënë, me kërkesën e cilësdo palë ose, në rrethana të jashtëzakonshme dhe me njoftim paraprak të palëve, me iniciativën e vet të tribunalit të arbitrazhit.
6. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga pala që kërkon një masë të përkohshme të jep sigurimet e duhura në lidhje me masën.
7. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga çdo palë që menjëherë të bëjë të ditur çdo ndryshim material në rrethanat në bazë të cilave masa e përkohshme është kërkuar ose caktuar.
8. Pala që kërkon një masë të përkohshme mund të jetë përgjegjëse për kompensimin e shpenzimeve dhe dëmeve të shkaktuara nga masa për çdo palë në qoftë se tribunali i arbitrazhit konstaton më vonë se, në rrethanat mbizotëruese në atë kohë, masa nuk duhet të ketë qenë caktuar. Tribunali i arbitrazhit mund të merr vendim për kompensim të shpenzimeve dhe dëmeve në çdo kohë gjatë procedurës.

9. Një kërkesë për masë të përkohshme e drejtuar nga cilado palë për një organ gjyqësor nuk do të konsiderohet e papajtueshme me marrëveshje të arbitrazhit, ose si një heqje dorë nga kjo marrëveshje.

Dëshmitë

Neni 28

1. Secila palë do të ketë barrën e të provuarit për fakte në mbështetje të padisë ose të mbrojtjes.
2. Dëshmitarët, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, të cilët janë paraqitur nga palët për të dëshmuar në tribunalin e arbitrazhit për ndonjë çështje të faktit ose të ekspertizës mund të jenë çdo individ, pavarësisht se individi është një palë e arbitrazhit, ose në ndonjë mënyrë në lidhje me një palë. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga tribunali i arbitrazhit, deklaratat e dëshmitarëve, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, mund të paraqiten me shkrim dhe të nënshkruhen nga ana e tyre.
3. Në çdo kohë gjatë procedurës së arbitrazhit tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të prodhojnë dokumente, prova materiale apo prova të tjera brenda një periudhe të tillë të kohës të përcaktuar nga tribunali i arbitrazhit.
4. Tribunali e arbitrazhit do të përcaktojë, pranueshmërinë, rëndësinë, materialitetin, dhe peshën e provave të ofruara.

Seancat dëgjimore

Neni 29

1. Në rast të një seancë dëgjimore, tribunali i arbitrazhit do të japë palëve njoftim adekuat paraprakisht për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës.
2. Dëshmitarët, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, mund të dëgjojnë në kushtet dhe merren në pyetje në mënyrë të caktuar nga tribunali i arbitrazhit.
3. Seancat dëgjimore nuk do të jenë publike përveç nëse palët pajtohen ndryshe. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë daljen nga salla të çdo dëshmitari ose të dëshmitarëve, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të tilla të tjerë, përveç se një dëshmitar, duke përfshirë edhe një dëshmitar ekspert, i cili është palë e arbitrazhit, në parim, nuk do të kërkojë të del nga salla.
4. Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që dëshmitarët, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, do të merren në pyetje me anë të mjeteve të telekomunikacionit që nuk kërkojnë praninë e tyre fizike në seancën dëgjimore (të tilla si video-konferencë).

Ekspertët e emëruar nga tribunali i arbitrazhit

Neni 30

1. Pas konsultimit me palët, tribunali i arbitrazhit mund të emërojë një ose më shumë ekspertë të pavarur për ti raportuar tribunalit, me shkrim, për çështje të veçanta që do të përcaktohen nga tribunali i arbitrazhit. Një kopje e përshkrimit të punëve të ekspertëve, hartuar nga tribunali i arbitrazhit, do të dorëzohet palëve.
2. Eksperti duhet, në parim para pranimit të emërimit, të paraqesë në gjykatën e arbitrazhit si dhe palëve, një përshkrim të kualifikimeve të tij ose të saj dhe një deklaratë mbi paanësinë dhe pavarësinë e tij apo të saj. Brenda kohës së urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit, palët duhet të informojnë tribunalin e arbitrazhit nëse ato kanë ndonjë kundërshtim në lidhje me kualifikimet, paanësinë, apo pavarësinë e ekspertit. Tribunali i arbitrazhit do të vendosë menjëherë nëse do të pranojë ndonjë kundërshtim të tillë. Pas emërimit të një eksperti, një palë mund të kundërshtojë kualifikimet, paanësinë ose pavarësinë e ekspertit vetëm nëse kundërshtimi është për arsye të cilat kjo palë i ka kuptuar pas emërimit. Tribunali i arbitrazhit do të vendosë menjëherë nëse duhet ndërmarrë ndonjë veprim.

3. Palët do ti japin ekspertit çdo informacion relevant ose ti parashtrojnë për inspektim të gjitha dokumentet ose sendet relevante që ai ose ajo mund të kërkojë prej tyre. Çdo mosmarrëveshje midis një palë dhe ekspertit në lidhje me rëndësinë e informacionit ose parashtrimin të kërkuar, do t'i referohet tribunalit të arbitrazhit për vendim.

4. Pas marrjes së raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit do të dorëzojë një kopje të raportit palëve, të cilat do ta kenë mundësinë për të shprehur, me shkrim, mendimin e tyre mbi raportin. Pala ka të drejtë të ekzaminojë çdo dokument në të cilën eksperti është mbështetur në raportin e tij ose të saj.

5. Me kërkesën e cilëdo palë, eksperti, pas dorëzimit të raportit, mund të dëgjohet në seancë, ku palët do të kenë mundësi të jenë të pranishme dhe të marrin në pyetje ekspertin. Në këtë seancë, çdo palë mund të paraqes dëshmitarë ekspert për të dëshmuar në pikat në fjalë. Dispozitat e nenit 28 do të zbatohen për procedurën e tillë.

Vonesa

Neni 31

1. Nëse brenda afatit të caktuar nga këto rregulla ose nga tribunali i arbitrazhit, pa treguar arsye të mjaftueshme, i paditurit nuk ka arritur të paraqes deklaratën e tij të mbrojtjes, tribunali i arbitrazhit do të urdhërojë që procedura të vazhdojë, pa trajtuar vonesën e tillë në vetvete si një pranim të pretendimeve të paditësit; dispozitat e këtij nën-paragrafi po ashtu zbatohen edhe për dështimin e paditësit të paraqesë mbrojtjen nga një kundërpadi ose për një padi për qëllimin e kompensimit të ndërsjellë.

2. Nëse një palë, e njoftuar me kohë sipas këtyre rregullave, nuk paraqitet në seancë, pa treguar arsye të mjaftueshme për dështim të tillë, tribunali i arbitrazhit mund të vazhdojë me procedurat e arbitrazhit.

3. Nëse një palë, e ftuar rregullisht nga tribunali i arbitrazhit për të paraqitur dokumente, prova materiale apo prova të tjera, nuk e bën këtë brenda periudhës së përcaktuar kohore, pa treguar arsye të mjaftueshme për dështim të tillë, tribunali i arbitrazhit mund të merr vendim bazuar në provat të cilat i ka në dispozicion.

Përfundimi i procedurës

Neni 32

1. Tribunali i arbitrazhit mund të pyes palët nëse kanë ndonjë provë të mëtejshme për të ofruar ose dëshmitar për tu dëgjuar ose të dorëzojnë parashtresa dhe, në qoftë se tribunalit i arbitrazhit është i konsideron se procesin, mund të shpallë procedurën të përfunduar.

2. Kur tribunalit i arbitrazhit shpallë mbylljen e seancës dëgjimore, ai tregon institucionit të arbitrazhit datën e përafërt gjer kur draft vendimi i dorëzohet institucionit të arbitrazhit për miratim sipas nenit 44. Çfarëdo shtyrje e kësaj date i komunikohet institucionit të arbitrazhit nga ana e tribunalit të arbitrazhit.

3. Tribunali i arbitrazhit mundet, nëse e konsideron të nevojshme për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, të vendosë, me nismën e vet ose me kërkesë të një pale, të rihap seancën dëgjimore në çdo kohë para nxjerrjes së vendimit.

Heqje dorë nga e drejta për kundërshtim

Neni 33

Dështimi nga cilado palë të kundërshtojë menjëherë për ndonjë mos-pajtueshmëri me këto rregulla ose me ndonjë kërkesë të marrëveshjes së arbitrazhit do të konsiderohet të jetë një heqje dorë nga e drejta e palës së tillë të bëjë një kundërshtim të tillë, përveç nëse pala e tillë mund të tregojë se, në bazë të rrethanave, dështimi i saj për të kundërshtuar ishte i justifikuar.

Vendimi

Vendimet

Neni 34

1. Kur ka më shumë se një arbitër, cilido vendim ose vendime të tribunalit të arbitrazhit do të merren nga shumica e arbitrave.
2. Në rastin e çështjeve procedurale, kur nuk ka shumicë ose kur tribunalin i arbitrazhit autorizon këtë, arbitri kryesues mund të vendosë vetëm, i cili vendim i nënshtrohet rishikimit, nëse ka, nga tribunalin i arbitrazhit.

Forma dhe ndikimi i vendimit

Neni 35

1. Tribunalin i arbitrazhit mund të merr vendime të veçanta për çështje të ndryshme në kohë të ndryshme.
2. Të gjitha vendimet duhet të përpilohen me shkrim dhe do të jenë përfundimtare dhe detyruese për palët. Palët do të zbatojnë të gjitha vendimet pa vonesë.
3. Tribunalin i arbitrazhit do të deklarojë arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar se nuk duhet të jepen arsye.
4. Vendimi duhet të nënshkruhet nga arbitrat dhe duhet të përmbajë datën në të cilën është marrë vendimi si dhe të tregojë vendin e arbitrazhit. Kur ka më shumë se një arbitër dhe asnjë prej tyre nuk arrin të nënshkruajë, vendimi do të përmbajë arsyetim për mungesën e nënshkrimit. Institucioni arbitrazhit do të vërtetojë se vendimi është miratuar sipas rregullave të brendshme të institucionit të arbitrazhit.
5. Vendimi mund të bëhet publik me pëlqimin e të gjitha palëve, ose ku dhe në masën që zbulimi është i nevojshëm nga një palë sipas ligjit, për të mbrojtur ose për të ndjekur një të drejtë ligjore, ose në lidhje me procedurat ligjore përpara një gjykate ose organi tjetër kompetent.
6. Kopjet e vërtetuara të vendimit, të nënshkruara nga arbitrat, do të dorëzohen palëve nga institucioni i arbitrazhit.

Ligji i aplikueshëm, amiable compositeur

Neni 36

1. Tribunalin i arbitrazhit do të zbatoj rregullat e ligjit të caktuar nga palët, si të zbatueshëm për thelbin e marrëveshjes. Në mungesë të përcaktimit të tillë nga palët, tribunalin i arbitrazhit do të zbatoj ligjin të cilin e përcakton të jetë i përshtatshëm.
2. Tribunalin e arbitrazhit do të vendosë si amiable compositeur ose ex aequo et bono vetëm në qoftë se palët e kanë autorizuar shprehimisht tribunalin e arbitrazhit për ta bërë këtë.
3. Në të gjitha rastet, tribunalin i arbitrazhit vendos në pajtim me kushtet e kontratës, nëse ka, dhe do të merr parasysh çdo përdorim të profesionit të zbatueshëm për transaksion.

Zgjidhja apo arsytet tjera për ndërprerje

Neni 37

1. Nëse, para marrjes së vendimit, palët pajtohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, tribunali i arbitrazhit do të lëshojë një urdhër për ndërprerjen e procedurës së arbitrazhit ose, në qoftë se kërkohet nga palët dhe pranohet nga tribunali i arbitrazhit, do të regjistrojë zgjidhjen në formën e një vendimi të arbitrazhit për kushtet e rëna dakord. Tribunali i arbitrazhit nuk është i obliguar për të dhënë arsyetim për një vendim të tillë.
2. Nëse, para marrjes së vendimit, vazhdimi i procedurës së arbitrazhit bëhet i panevojshëm ose i pamundur për ndonjë arsye që nuk është përmendur në paragrafin 1, tribunali i arbitrazhit do të informojë palët mbi qëllimin e tij për të nxjerrë një urdhër për ndërprerjen e procedurës. Tribunali i arbitrazhit do të ketë fuqinë për të nxjerrë një urdhër të tillë përveç nëse nuk ka çështje të mbetura që duhet të vendosen dhe tribunali i arbitrazhit e konsideron të përshtatshme për ta bërë këtë.
3. Kopjet e urdhrin për ndërprerjen e procedurës së arbitrazhit ose të vendimit të tribunalit të arbitrazhit për kushtet e rëna dakord, të nënshkruara nga arbitrat, do të dorëzohen palëve. Ku është marrë vendimi i arbitrazhit për kushtet e rëna dakord, do të zbatohen dispozitat e nenit 35, paragrafët 2, 4 dhe 5.

Interpretimi i vendimit

Neni 38

1. Brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit, një palë, me njoftim palëve të tjera, mund të kërkojë që tribunali i arbitrazhit të japë një interpretim të vendimit.
2. Interpretimi do të jepet me shkrim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës. Interpretimi do të jetë pjesë e vendimit dhe dispozitat e nenit 35, paragrafët 2 deri 6, do të zbatohen.

Korrigjimi i vendimit

Neni 39

1. Brenda 30 ditëve pas marrjes së vendimit, një palë, me njoftim palëve të tjera, mund të kërkojë nga tribunali i arbitrazhit të korrigjojë në vendim ndonjë gabim në llogaritje, çdo gabim shtypi ose tipografik, ose ndonjë gabim ose lëshim të një natyre të ngjashme. Nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se kërkesa është e arsyeshme, do të bëjë korrigjimin brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.
2. Tribunali i arbitrazhit mundet brenda 30 ditësh nga dorëzimi i vendimit të bëjë korrigjimet e tilla me iniciativë të vet.
3. Korrigjimet e tilla do të bëhen me shkrim dhe do të jenë pjesë e vendimit. Dispozitat e nenit 35, paragrafët 2 deri 6, zbatohen.

Vendimet shtesë

Neni 40

1. Brenda 30 ditëve pas pranimit të urdhrin mbi ndërprerjen apo të vendimit, pala, me njoftim palëve të tjera, mund të kërkojë nga tribunali i arbitrazhit të merr një vendim ose një vendim shtesë, në lidhje me pretendimet e paraqitura në procedurën e arbitrazhit, por të cilat nuk janë vendosur nga tribunali i arbitrazhit.
2. Nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se kërkesa për një vendim ose vendim shtesë është e bazuar, ai do të merr ose do të plotësojë vendimin e tij brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës. Tribunali i arbitrazhit mund të zgjasë, nëse është e nevojshme, periudhën kohore brenda së cilës do të merr vendimin.
3. Kur një vendim i tillë ose një vendim shtesë është marrë, dispozitat e nenit 35, paragrafët 2 deri 6, zbatohen.

Konfidencialiteti

Neni 41

1. Përveç nëse palët shprehimisht bien dakord me shkrim për të kundërtën, palët marrin përsipër si një parim i përgjithshëm për të ruajtur të fshehtë procedurën e arbitrazhit mbajtur të fshehtë të gjitha vendimet dhe urdhrat, si dhe të gjitha materialet e paraqitura nga një palë tjetër në kuadër të procedurës së arbitrazhit dhe që nuk janë ndryshe në sferën publike, të ruajnë dhe në atë masë që një deklaramund të kërkohet nga një palë me një detyrë ligjore, të mbrojnë ose të ndjekin një të drejtë ligjore, ose të zbatojnë ose të kundërshtojnë një vendim në procedurat juridike para një autoriteti gjyqësor. Kjo ndërmarrje vlen edhe për arbitrat, ekspertët, dëshmitarët, personat që veprojnë në emër të çfarëdo personi të përfshirë në procedurën e arbitrazhit, sekretarin e tribunalit të arbitrazhit dhe çdo person të institucionit të arbitrazhit të përfshirë në administrimin e procedurës së arbitrazhit.

2. Shqyrtimet e tribunalit të arbitrazhit janë konfidenciale.

3. Një vendim mund të publikohet, nëse në tërësi ose në formë të fragmenteve apo një përmbledhje, vetëm sipas kushteve të mëposhtme:

- (a) Një kërkesë për publikim i drejtohet një institucioni të arbitrazhit;
- (b) Të gjitha referencat për emrat e palëve janë shlyer; dhe
- (c) Asnjë palë nuk e kundërshton publikimin e tillë brenda afatit kohor të caktuar për këtë qëllim nga institucioni i arbitrazhit.

Procedura e përshpejtuar

Neni 42

1. Dispozitat në lidhje me procedurën e përshpejtuar, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, do të zbatohen:

- (a) për të gjitha rastet në të cilat shuma në mosmarrëveshje që paraqet shumën totale të padisë dhe kundërpadisë (ose ndonjë mbrojtje për kompensimin e ndërsjellë) nuk i kalon 100,000 Euro, përveç nëse institucioni i arbitrazhit nuk vendos ndryshe duke marrë parasysh të gjitha rrethanat;
- (b) për të gjitha rastet, pavarësisht nga vlera e tyre, nëse palët bien dakord për zbatimin e dispozitave të procedurës së përshpejtuar.

2. Në procedurën e përshpejtuar, dispozitat e mësipërme të këtyre rregullave zbatohen në përputhje me ndryshimet e mëposhtme:

- (a) Institucioni i arbitrazhit mund të shkurtojë afatet, duke përfshirë edhe afatet kohore për emërimin e arbitrave;
- (b) Rasti do të referohet një arbitri të vetëm, përveç nëse marrëveshja e arbitrazhit parasheh tribunalin e arbitrazhit me tre anëtarë. Në qoftë se marrëveshja e arbitrazhit parasheh tribunalin e arbitrazhit me tre anëtarë, institucioni i arbitrazhit do të ftojë palët të bien dakord që çështja të referohet një arbitri të vetëm. Nëse palët nuk bien dakord për ta referuar rastin një arbitri të vetëm, tarifat e tre arbitrave do të llogariten në përputhje me Nenin 8 të Vendimit për shpenzimet në procedurën e arbitrazhit.
- (c) Përveç nëse palët pajtohen se mosmarrëveshja do të vendoset vetëm në bazë të provave dokumentare, tribunali i arbitrazhit nuk do të mbajë më tepër se një seancë dëgjimore për ekzaminimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe për argumentet me gojë. Me kërkesë nga tribunali i arbitrazhit, institucioni i arbitrazhit mund përjashtimisht të lejojë mbajtjen e një seance tjetër.
- (d) Vendimi do të merret brenda gjashtë muajve nga data kur institucioni i arbitrazhit ka dorëzuar shkresat e lëndës tribunalit të arbitrazhit. Në rrethana të jashtëzakonshme, institucioni i arbitrazhit mund ta zgjasë këtë afat.

Kompetencat e institucionit të arbitrazhit

Kompetencat gjatë procedurës

Neni 43

1. Institucioni i arbitrazhit mundet, në përputhje me rregullat e brendshme, të autorizojë një nga anëtarët e tij të merr pjesë në seancat dëgjimore.
2. Institucioni i arbitrazhit do të sigurojë ndihmë adekuate ligjore në të gjitha seancat ku arbitri i vetëm, ose të paktën një anëtar i tribunalit të arbitrazhit nuk është jurist.
3. Institucioni i arbitrazhit mundet, duke respektuar të drejtën e vendimmarrjes të tribunalit të arbitrazhit mbi meritat e mosmarrëveshjes, të tërheqë vëmendjen e arbitrave për çështjet ligjore të rëndësishme për vendimmarrje dhe në veçanti për çështjet që lidhen me përmbajtjen dhe formën e veprimeve procedurale të cilat janë duke u ndërmarrë.

Miratimi i vendimit

Neni 44

1. Para nënshkrimit të vendimit, tribunalit i arbitrazhit është i detyruar të paraqesë në institucionin e arbitrazhit draftin e vendimit për miratim.
2. Institucioni i arbitrazhit mund të urdhërojë ndryshimet në formën e draftit të paraqitur. Institucioni i arbitrazhit, duke respektuar të drejtën e vendimmarrjes të tribunalit të arbitrazhit mbi meritat e mosmarrëveshjes, është i autorizuar për të tërhequr vëmendjen e tribunalit të arbitrazhit për çështjet që lidhen me meritat e mosmarrëveshjes.

Shpenzimet e procedurës

Neni 45

Shpenzimet e procedurës së arbitrazhit (duke përfshirë edhe tarifat e arbitrave, shpenzimet administrative, parapagimet e shpenzimeve, paraqitjen e provave dhe shpenzimet e tjera) do të përcaktohen nga Institucioni i Arbitrazhit në pajtim me Vendimin për shpenzimet e procedurës së arbitrazhit në fuqi në kohën para se të fillojë procedura e arbitrazhit.

Hyrja në fuqi

Neni 46

Këto rregulla do të hyjnë në fuqi më 1 korrik 2011.

Shtojcë

Modeli i klauzolës së arbitrazhit për kontrata

Cilado mosmarrëveshje, kontrovers ose pretendim që dalin nga apo në lidhje me këtë kontratë, ose shkelje, ndërprerje ose jo-vlefshmëri me këtë, do të zgjidhet me arbitrazh në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Kosovës.

Shënim. Palët duhet të marrin në konsideratë për të shtuar:

- (a) Autoriteti i emërimit duhet të jetë ... [emri i institucionit ose personit];
- (b) Numri i arbitrave do të jetë... [një ose tre];
- (c) Vendi i arbitrazhit do të jetë ... [qyteti dhe vendi];
- (d) Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë
- (d) Ligji i aplikueshëm i të drejtës materiale është

Modeli i deklaratës mbi pavarësinë në bazë të nenit 11 të Rregullave

Asnjë rrethanë për tu zbuluar

Unë jam i paanshëm dhe i pavarur nga palët dhe do të mbetem kështu. Sipas njohurive të mia, nuk ka rrethana, të kaluara ose aktuale, që mund të shkaktojnë dyshime të arsyeshme për paansësinë ose pavarësinë time. Unë do të njoftoj menjëherë palët dhe arbitrat e tjerë për çfarëdo rrethana të tilla që mund të vijnë në vëmendjen time gjatë këtij arbitrazhi.

Rrethanat për tu zbuluar

Unë jam i paanshëm dhe i pavarur nga palët dhe do të mbetem kështu. Bashkëngjitur është një deklaratë e bërë në bazë të nenit 10 të Rregullave të Arbitrazhit në KOSOVË mbi (a) lidhjet e mia të kaluara dhe të tani të biznesit, profesionale, dhe marrëdhënie të tjera me palët dhe (b) rrethana të tjera të rëndësishme. [të bashkëngjitet deklarata]. Unë konfirmoj se këto rrethana nuk ndikojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë time. Unë do të njoftoj menjëherë palët dhe arbitrat e tjerë për çfarëdo rrethana të tilla që mund të vijnë në vëmendjen time gjatë këtij arbitrazhi.

Shënim. Cilado palë mund të konsiderojë të kërkojë nga arbitri shtesën e mëposhtme për deklaratën e pavarësisë:

Unë konfirmoj, mbi bazën e informacionit që kam aktualisht në dispozicion, që unë mund të kushtoj kohën e nevojshme për të kryer këtë arbitrim me zell, në mënyrë efikase dhe në përputhje me afatet kohore në rregulla.



**Vendim mbi caktimin e
tarifave mbi shpenzimet e
procedurës së arbitrazhit**

Vendim mbi caktimin e tarifave mbi shpenzimet e procedurës së arbitrazhit

VENDIM MBI CAKTIMIN E TARIFAVE MBI SHPENZIMET E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT	23
I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	23
II. TARIFAT	25
III. Shpenzimet Administrative	26
IV. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	26



VENDIM MBI CAKTIMIN E TARIFAVE MBI SHPENZIMET E PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1 Ky vendim përcakton rregullat lidhur me shpenzimet e parapara në Rregullat e Arbitrazhit në Kosovë, të administruara nga Qendra për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve pranë Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm "QZAK").

Neni 2

2.1 Palët që marrin pjesë në procedura pranë QZAK i bartin shpenzimet e procedurës:

2.2 Shpenzimet e procedurës përbëhen nga:

- (a) Tarifata e tribunalit të arbitrazhit;
- (b) Shpenzimet dhe tarifata administrative të QZAK;
- (c) Shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit dhe shpenzimet tjera që janë bërë nga arbitrat;
- (d) Shpenzimet e arsyeshme të këshillave të ekspertëve dhe të ndihmës tjetër që kërkohen nga tribunali i arbitrazhit;
- (e) Shpenzimet e arsyeshme të udhëtimit dhe shpenzimet tjera të dëshmitarëve deri në masën në të cilën ato shpenzime miratohen nga tribunali i arbitrazhit;
- (f) Shpenzimet juridike dhe shpenzime të tjera të bëra nga palët lidhur me arbitrimin deri në masën që përcaktohet nga tribunali i arbitrazhit i cili vlerëson nëse shuma e atyre shpenzimeve është e arsyeshme;
- (g) Shpenzimet tjera materiale të procedurave të arbitrazhit (shpenzimet e seancave, që janë mbajtur jashtë ndërtesës së QZAK).

2.3 Shpenzimet e procedurës sipas paragrafëve 2 (a), (b), (c), (e) dhe (g) caktohen nga QZAK në pajtim me tarifata e parapara në Shpenzimet e Arbitrimin të këtij vendimi. Shpenzimet e procedurave sipas paragrafit 2(d), dhe (f) përcaktohen nga tribunali i arbitrazhit

2.4 Lidhur me interpretimin, korrigjimin apo plotësimin e çfarëdo shpërblimi në bazë të neneve 37 deri 39, QZAK mund t'i ngarkojë shpenzimet e referuara në paragrafët 2(b) deri 2 (g), por jo edhe shpenzime tjera shtesë.

Neni 3

3.1 Shpenzimet e arbitrazhit në parim i bartë pala ose palët e pasuksesshme. Mirëpo, tribunali i arbitrazhit mund t'i ndajë shpenzimet e tilla në mes të palëve nëse e konstaton që kjo ndarje është e arsyeshme, duke i pasur para sysh rrethanat e rastit.

3.2 Tribunali i arbitrazhit në shpërblimin përfundimtar apo nëse e konsideron të duhur, në çfarëdo shpërblimi tjetër, përcakton cilëndo shumë që pala duhet t'ia paguaj palës tjetër si rezultat i vendimit për ndarjen e shpenzimeve.

Neni 4

4.1 Gjatë parashtrimit të deklaratës së kërkesës apo kundërkërkesës, kërkuesi (kundër-kërkuesi) ia paguan QZAK-së tarifën e regjistrimit të paraparë në Shpenzimet e Arbitrimit të këtij vendimi.

4.2 Nëse në kontest janë të përfshira më shumë se dy palë, si bashkë-ndërgjyqës, tarifa e regjistrimit do të rritet për 10% për secilën palë shtesë.

4.3 Tarifa e paguar e regjistrimit nuk kthehet.

4.4 QZAK nuk e bënë dërgimin e deklaratës së kërkesëpadsisë dhe nuk ndërmerr asnjë veprim procedural derisa të paguhet tarifa e regjistrimit.

Neni 5

5.1 Pasi të jetë përcaktuar numri i arbitërve në procedurë (p.sh një ose tre), shuma e avansit të shpenzimeve të pritura të procedurës nga neni 2, paragrafi 2 (a) deri (e) përcaktohet nga QZAK.

5.2 QZAK kërkon nga secila palë depozitim e një shume të barabartë si avans për shpenzimet e parapara në paragrafin 1. Në rrethana të caktuara, QZAK mund të zgjedhë që të kërkojë pagesën e plotë të avansit vetëm nga kërkuesi.

5.3 Nëse depozitat e kërkuara nuk paguhen plotësisht brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës, QZAK i njofton palët lidhur me këtë në mënyrë që njëra apo tjetra palë të bëjë pagesën e kërkuar. Nëse kjo pagesë nuk bëhet, QZAK mund të urdhërojë pezullimin apo ndërprerjen e procedurave të arbitrit.

5.4 Deklarata e kërkesëpadsisë nuk i dërgohet tribunalit të arbitrazhit, para pagimit të shumës nga paragrafi 1 i këtij neni.

5.5 Gjatë procedurave, nëse ka çfarëdo rritje të vlerës së lëndës së kontestit apo nëse avansi i paguar nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet materiale, QZAK mund të kërkojë nga palët që të paguajnë depozitë shtesë.

5.6 Deri në pagimin e depozitës shtesë, të ngarkuar për shkak të rritjes së vlerës së lëndës së kontestit, rritja nuk do të merret parasysht.

5.7 Nëse depozita shtesë kërkohet për mbulimin e shpenzimeve materiale, procedura e arbitrit nuk vazhdon derisa depozita shtesë të jetë paguar.

5.8 Zvogëlimi i vlerës së lëndës së kontestit do të merret parasysht gjatë llogaritjes së shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të arbitërve, vetëm nëse QZAK njoftohet për këtë para dorëzimit të dosjes në tribunalin e arbitrazhit.

Neni 6

6.1 Nëse depozita nuk paguhet me kohë, QZAK merr vendim për fshirjen e deklaratës së kërkesës nga regjistri i kontesteve në QZAK.

6.2 Deklarata e fshirë e kërkesës mund të parashtrohet prapë pas pagesës së serishme të tarifës së regjistrimit.

6.3 Pas marrjes së urdhrin për ndërprerje apo pasi të jetë dhënë shpërblimi përfundimtar, tribunali i arbitrazhit e bënë një llogaritje për palët lidhur me depozitat e pranuar dhe çdo bilanc të papritur ua kthen palëve.

Neni 7

7.1 Palët i paguajnë depozitat në xhirollogaritë e përcaktuara nga QZAK.

II.TARIFAT

Neni 8

SHPENZIMET E ARBITRIMIT

Tarifa nr. 1

Tarifa e regjistrimit për procedurat e arbitrimin është:

- 250 EUR, nëse shuma e kontestit është më e vogël se 100.000 EUR;
- 500 EUR nëse shuma e kontestit është e barabartë ose më e madhe se 100.000 EUR.

TARIFAT E ARBITËRVE

Tarifa nr. 2

Nëse arbitrimi bëhet nga një arbitër i vetëm, shpenzimet për tarifën e arbitrit duhet të llogariten në përputhje me këtë tabelë:

Vlera ekuivalente e lëndës së kontestit (nga deri) në EUR		Shuma e tarifave: bazë (C) dhe përqindja (D) për shumën që e tejkalon (A) – në EUR	
Nga (A)	deri (B)	Baza (C)	% (D)
	5,000	600	
5,000	20,000	600	7
20,000	50,000	1,650	5
50,000	100,000	3,150	3
100,000	500,000	4,650	1,5
500,000	2,000,000	10,650	1
2,000,000	5,000,000	25,650	0.5
5,000,000	10,000,000	40,650	0,3
10,000,000	20,000,000	55,650	0,1
përmbi 20,000,000		65,650	0,05

Tarifa nr. 3

Nëse palët duhet të paguajnë depozitë për shpenzime administrative dhe shpenzime të arbitërve në pjesë të barabarta, me qëllim të llogaritjes së shumës së këtyre shpenzimeve, vlerat e lëndës së kontestit nga deklarata e kërkesës dhe kundërkërkesës do të bashkohen. Nëse jo depozita për këto shpenzime llogaritet ndarazi për deklaratën e kërkesës dhe kundërkërkesës (llogaritje e ndarë).

Llogaritjet e ndara gjithashtu aplikohen nëse kundërkërkesa nuk ka të bëjë me deklaratën e kërkesës.

Nëse në procedurat e njëjta, janë parashtruar disa deklarata të kërkesës dhe kundërkërkesës, QZAK mund të llogarisë tarifën e arbitërve ndarazi për secilën kërkesë.

Tarifa nr. 4

Nëse duhet të caktohet Tribunali i arbitrazhit prej tre anëtarëve, shuma nga tarifa nr. 2 rritet për dy herë e gjysmë. Në rastet veçanërisht të ndërlikuara, QZAK mund të urdhërojë që shuma nga tarifa nr. 2 të rritet për tri herë.

Nëse në procedurë marrin pjesë më tepër se dy palë si bashkë-ndërgjyqës, shuma në tarifën nr. 2 rritet për 10 për qind për secilën palë shtesë.

Tarifa nr. 5

Nëse procedurat e arbitrit nuk përfundojnë me dhënien e shpërblimit të arbitrit, QZAK e përcakton shumën e tarifave të arbitërve si dhe shpenzimet administrative në shumën e duhur dhe merr vendim lidhur me shpajimin e palëve për shumën e depozituar që nuk është shpenzuar.

III. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

Tarifa nr. 6

Nëse është caktuar një arbitër i vetëm, shpenzimet administrative janë 20 përqind të shumës së tarifave për një arbitër të vetëm.

Nëse është caktuar një tribunal i arbitrazhit, shpenzimet administrative janë 10 përqind nga shuma e tarifave për tribunalin e arbitrazhit.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 9

Ky vendim hyn në fuqi më datën 1 korrik 2011.

Aprovuar më 27 Qershor, 2011 në Prishtinë, Kosovë

Bordi i Drejtorëve të QZAK-së

Ligji për arbitrazhin



Ligji për arbitrazhin

LIGJI PËR ARBITRAZHIN	29
Kreu I.....	29
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	29
Kreu II	30
MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT	30
Kreu III	31
PËRBËRJA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT.....	31
Kreu IV	32
KOMPETENCA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT.....	32
Kreu V	33
PROCEDURAT E ARBITRAZHIT.....	33
Kreu VI	36
VENDIMET.....	36
Kreu VII	38
PROCEDURA GJYQËSORE	38
Kreu VIII	39
NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT.....	39
Kreu IX	40
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	40

LIGJI PËR ARBITRAZHIN

Kuvendi i Kosovës

Në mbështetje të Kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 datë 15 maj 2001), dhe

Me qëllim të rregullimit të lëndës së arbitrazhit dhe të ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës në pajtim me standardet bashkëkohore Evropiane dhe ndërkombëtare,

Miraton:

LIGJIN PËR ARBITRAZHIN

Kreu I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohen rregullat që zbatohen për marrëveshjet e arbitrazhit, procedurat e arbitrazhit si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

“Marrëveshja e Arbitrazhit” nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit.

“Vendim” përfshin të gjitha urdhrat e nxjerra nga tribunali i arbitrazhit, qofshin ato të përkohshme, të pjesshme, procedurale, meritore ose përfundimtare, lidhur me të gjitha çështjet, përfshirë këtu edhe shpenzimet.

“Konsumator” do të thotë çdo person fizik i cili lidhë kontratë për qëllime që nuk kanë të bëjnë me tregti, afarizmin ose profesionin e tij.

“Person” përfshin të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Në kuadër të personave juridik bëjnë pjesë personat juridik të së drejtës private si dhe personat juridik të së drejtës publike.

“Gjykatë” në këtë ligj i referohet gjykatës së caktuar në marrëveshjen e arbitrazhit ose, në mungesë të një përcaktimi të tillë, Gjykatës Ekonomike.

“Tribunal” nënkupton tribunalin e arbitrazhit.

Neni 3

Kompetencat e gjykatës

Asnjë gjykatë në Kosovë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në procedurën e arbitrazhit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

Neni 4

Njoftimi dhe llogaritja e afateve kohore

4.1. Të gjitha njoftimet, kumtesat ose parashtresat konsiderohen se janë pranuar nëse ato i janë dorëzuar personalisht personit të adresuar, ose nëse i dërgohen personit të adresuar përmes postës së regjistruar në vendbanimin e tij, në vendin ku ai e ushtron afarizmin ose në adresën e tij postare. Nëse asnjëra nga lokacionet e lartpërmendura nuk mund të gjinden, njoftimi konsiderohet se është pranuar nëse ai i dërgohet personit të adresuar në vendbanimin ose vendin e ushtrimit të afarizmit të fundit të njohur.

Njoftimi konsiderohet se është pranuar në ditën kur është bërë dorëzimi i tij. Dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen lidhur me njoftimet dhe parashtresat e dorëzuara gjatë procedurave gjyqësore.

4.2. Të gjitha afatet kohore të parapara në këtë ligj fillojnë të ecin një ditë pas pranimit të njoftimit. Nëse dita e fundit e këtij afati kohor është festë zyrtare ose nuk është ditë pune në vendbanimin ose vendin e afarizmit të personit të adresuar, atëherë afati kohor përfundon në ditën e parë vijuese të punës. Festat zyrtare ose ditët që nuk janë ditë pune duhet të përfshihen në llogaritjen e afatit kohor.

Kreu II

MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

Neni 5

Arbitrabiliteti

5.1. Një mosmarrëveshje mund të zgjidhet përmes arbitrazhit vetëm nëse ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë që mosmarrëveshja të zgjidhet përmes arbitrazhit.

5.2. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomike-juridike mund t'i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse është e ndaluar me ligj.

Neni 6

Marrëveshja e arbitrazhit

6.1. Marrëveshja e arbitrazhit lidhet në formë të shkruar.

6.2. Kushti i mësipërm konsiderohet se është përmbushur edhe nëse lidhja e marrëveshjes së arbitrazhit dokumentohet në formë të këmbimit të letrave, telefaksit, telegramit ose mënyrave të tjera të telekomunikimit ose komunikimit elektronik, në formë të konosmanit, nëse konosmani përmban shprehimisht një klauzolë të arbitrazhit, ose në rast të paraqitjes së padisë dhe të përgjigjes në padi, në kuadër të së cilës njëra palë pretendon se ekziston një marrëveshje arbitrazhi dhe pala tjetër nuk e konteston këtë.

6.3. Nëse një konsumator është palë në marrëveshjen e arbitrazhit, marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet të jetë lidhur në formën e shkruar vetëm nëse të gjitha palët në marrëveshjen e arbitrazhit e nënshkruajnë personalisht dokumentin që përmban klauzolën e arbitrazhit. Nënshkrimi i cekur në këtë paragraf mund të zëvendësohet me nënshkrimin elektronik në përputhje me legjislacionin përkatës për nënshkrimet elektronike.

6.4. Mospërmbushja e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni nuk merret parasysh nga tribunali i arbitrazhit, nëse palët e kanë inicuar procedurën e arbitrazhit.

Neni 7

Paditë para Gjykatave

Gjykata, para së cilës është ngritur një padi lidhur me një çështje, e cila i nënshtrohet arbitrazhit, e hedh poshtë padinë, nëse i padituri në përgjigjen e tij ndaj padisë thirret në marrëveshjen e arbitrazhit, përveç nëse gjykata konstaton se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme ose që çështja kontestuese nuk mbulohet nga marrëveshja e arbitrazhit.

Neni 8

Masat e përkohshme të gjykatës

Pa marrë parasysh marrëveshjen e arbitrazhit ose fillimin e procedurës së arbitrazhit, gjykata kompetente mund të merr masa të përkohshme, nëse kjo kërkohet nga njëra palë e cila paraqet prova të besueshme se asaj mund t'i shkaktohet dëm ose humbje e menjëhershme ose e pariparueshme nëse nuk merret masa e përkohshme.

Kreu III

PËRBËRJA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

Neni 9

Numri dhe emërimi i arbitërve

9.1. Tribunali i arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm ose nga një trup arbitrash, me kusht që numri i arbitrave të këtij trupi të jetë një numër tek.

9.2. Palët mund të merren vesh për procedurën e emërimit të arbitrit ose të arbitrave.

9.3. Nëse palët nuk merren vesh për numrin e arbitrave ose për procedurën e emërimit të tyre brenda 15 ditëve pasi që i padituri të ketë pranuar njoftimin për arbitrazh, tribunali i arbitrazhit do të përbëhet nga një trup prej 3 arbitërve të cilët emërohen sipas paragrafit 4 të këtij neni.

9.4. Në rastin e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, secila palë emëron një arbitër. Dy arbitrat e emëruar, e emërojnë arbitrin e tretë i cili do të jetë drejtues i tribunalit të arbitrazhit. Nëse njëra pala nuk e emëron arbitrin brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës për ta bërë këtë, ose nëse dy arbitrat nuk merren vesh për emërimin e arbitrit të tretë brenda tridhjetë ditëve nga emërimi i tyre, atëherë me kërkesën e njëjës palë arbitri përkatës emërohet nga Gjykata.

9.5. Përveç nëse palët pajtohen ndryshe, pala, e cila e ka bërë emërimin e arbitrit, është e lidhur për këtë emërim prej momentit, kur pala tjetër ta ketë pranuar njoftimin për emërimin e arbitrit.

9.6. Kur Gjykata e emëron arbitrin, ajo i merr parasysh kualifikimet të cilat arbitri duhet t'i plotësojë sipas marrëveshjes së arbitrazhit dhe duhet të sigurojë që arbitri të jetë i pavarur, i paanshëm dhe të mos ketë ndonjë konflikt interesi.

Neni 10

Përgjashtimi i arbitrit

10.1. Personi, të cilit njëra palë ose Gjykata i drejtohet për emërim si arbitër, ka për detyrë t'i bëjë publike të gjitha rrethanat të cilat mund të shkaktojnë dyshime lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e tij. Arbitri, pas emërimit, duhet t'i bëjë publike rrethanat e tilla para palëve nëse palët nuk janë njoftuar paraprakisht për këto rrethana.

10.2. Secila palë mund të kërkojë përjashtimin e cilitdo arbitër, nëse ajo ka dyshime të arsyeshme lidhur me pa-anësinë ose pavarësinë e arbitrit, ose nëse arbitri nuk i posedon kualifikimet për të cilat palët janë pajtuar. Pala mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të cilin e ka emëruar ajo, vetëm nëse arsyet për përjashtimin e tij kanë lindur pas emërimit të arbitrit. Pala gjegjëse ka për detyrë të kërkojë përjashtimin e arbitrit menjëherë pasi të njoftohet për rrethanat të cilat e arsyejnë përjashtimin.

*Neni 11***Procedura për përjashtimin e arbitërve**

11.1. Palët mund të merren vesh për procedurën e përjashtimit të një arbitri. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni zbatohen, nëse palët nuk janë pajtuar për një procedurë të tillë.

11.2. Brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga emërimi i arbitrit ose pasi të jetë njoftuar për rrethanat e përcaktuara me nenin 10, paragrafi 2, pala e cila kërkon përjashtimin e një arbitri ka për detyrë, t'i dërgojë palës tjetër dhe anëtarëve tjerë të tribunalit një njoftim për përjashtimin. Njoftimi duhet të bëhet me shkrim dhe në të duhet të theksohen arsyet për përjashtim.

11.3. Nëse arbitri nuk jep dorëheqje ose pala tjetër nuk pajtohet me përjashtimin, tribunali i arbitrazhit vendos mbi kërkesën për përjashtimin e arbitrit.

11.4. Nëse kërkesa për përjashtimin e arbitrit nuk është e suksesshme sipas procedurës për të cilën janë pajtuar palët ose sipas procedurës së paraparë në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, atëherë pala përkatëse mund të paraqesë kërkesën për përjashtimin e arbitrit para Gjykatës brenda 15 ditëve prej ditës së pranimit të njoftimit për refuzimin e kërkesës për përjashtim. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankesa. Përderisa Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën, tribunali i arbitrazhit, duke përfshirë edhe arbitrin përjashtimi i të cilit kërkohet, mund të vazhdojë me procedurën e arbitrazhit dhe të nxjerr vendim.

*Neni 12***Moskryerja e detyrës**

12.1. Nëse arbitri për arsye juridike ose faktike nuk mund t'i ushtrojë detyrat e tij ose për shkaqe tjera nuk i ndërmerr veprimet pa vonesë të arsyeshme, mandati i tij përfundon nëse jep dorëheqje ose kur palët pajtohen për përfundimin e mandatit të tij. Nëse arbitri nuk jep dorëheqje ose nëse palët nuk pajtohen lidhur me përfundimin e mandatit, me kërkesën e njëres palë ose të ndonjë anëtari të tribunalit, Gjykata vendos për përfundimin e mandatit të arbitrit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk është e lejuar ankesa.

12.2. Nëse sipas paragrafit 1 të këtij neni ose neni 11, paragrafi 2, arbitri jep dorëheqje ose palët pajtohen për përfundimin e mandatit të arbitrit, kjo nuk nënkupton se ekziston njëra prej arsyeve të parapara në këtë nen ose në nenin 11, paragrafi 2.

*Neni 13***Zëvendësimi i arbitrit**

Në rast se mandati i një arbitri përfundon sipas neni 11 ose 12 ose për shkak të dorëheqjes së tij, atëherë emërohet një zëvendës arbitër sipas dispozitave për emërimin e arbitrave, përveç nëse palët dakordohen për një procedurë tjetër.

Kreu IV**KOMPETENCA E TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT***Neni 14***Kompetenca**

14.1. Tribunali i arbitrazhit vendos mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit dhe se a është kompetent për zgjidhjen e kontestit i cili i është parashtruar. Në këtë kontekst, klauzola e arbitrazhit, e cila është pjesë e një kontrate, trajtohet si marrëveshje e veçantë dhe e pavarur prej kontratës.

14.2. Kundërshtimin, se tribunali i arbitrazhit nuk është kompetent, pala duhet ta dorëzojë më së voni deri në momentin e dorëzimit të përgjigjes në padi. Pala nuk mund të privohet nga e drejta e paraqitjes së kundërshtimit në fjalë, për shkak se e ka emëruar ose ka marrë pjesë në emërimin e një arbitri.

14.3. Kundërshtimi, se tribunali i arbitrazhit e ka tejkaluar kompetencën e vet, duhet të paraqitet nga pala menjëherë pasi të vihet në dijeni për këtë.

14.4. Në rastet e parapara me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, tribunali i arbitrazhit mund të pranojë një kundërshtim të paraqitur me vonesë, nëse konstaton se pala ka arsyetim të pranueshëm për këtë vonesë.

14.5. Secila palë mund të kërkojë nga gjykata që të shqyrtojë vendimin e tribunalit të arbitrazhit lidhur me kompetencën e tij mbi kontestin përkatës. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet në gjykatë brenda tridhjetë ditëve prej ditës së pranimit të njoftimit me shkrim mbi vendimin. Paraqitja e kërkesës nuk e ndalon tribunalin e arbitrazhit që të vazhdojë me procedurën e arbitrazhit dhe të nxjerr vendim.

Neni 15

Masat e përkohshme

15.1. Përveç nëse palët pajtohen ndryshe, tribunali i arbitrazhit, me kërkesën e njëjës pale, mund të urdhërojë marrjen e masës së përkohshme, nëse pala paraqet prova të besueshme se asaj mund t'i shkaktohet dëm ose humbje e menjëhershme ose e riparueshme në rast se nuk merret një masë e këtillë. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga secila palë që të deponojë mjete siguroese lidhur me masat e tilla të përkohshme.

15.2. Me kërkesën e palës, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e masës së përkohshme të urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç kur sipas nenit 8, për çështjen e njëjtë, pala e ka kërkuar masën e përkohshme.

15.3. Nëse konstatohet se masa e përkohshme e urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit sipas paragrafit 1 të këtij neni ka qenë e paarsyeshme, pala në dobi të së cilës është urdhëruar masa e përkohshme ka për detyrë ta kompensojë dëmin të cilin e ka pësuar pala tjetër si pasojë e ekzekutimit të masës së përkohshme. Tribunali i arbitrazhit është kompetent për të vendosur lidhur me arsyeshmërinë e masës së përkohshme dhe për çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të lartpërmendur.

Kreu V

PROCEDURAT E ARBITRAZHIT

Neni 16

Rregullat e përgjithshme

16.1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secila palë duhet të ketë mundësinë e plotë që të paraqesë rastin e saj në secilën fazë të procedurës së arbitrazhit.

16.2. Palët janë të lira në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, të cilët do t'i përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit. Asnjë përfaqësues i autorizuar nga pala, nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit.

16.3. Pa cenuar dispozitat e detyrueshme të këtij ligji, palët mund të pajtohen mbi procedurën e arbitrazhit.

16.4. Nëse palët nuk janë pajtuar për procedurën e arbitrazhit dhe në mungesë të dispozitave përkatëse në këtë ligj, tribunali i arbitrazhit i përcakton vet rregullat e arbitrazhit duke i zbatuar përshtatshmërisht rregullat e procedurës kontestimore ose duke i zbatuar rregullat e arbitrazhit të një institucioni të arbitrazhit të përhershëm.

Neni 17

Vendi i arbitrazhit

17.1. Nëse palët nuk janë pajtuar mbi vendin ku duhet të mbahet arbitrazhi, tribunali i arbitrazhit e cakton vendin e mbajtjes së arbitrazhit duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe përshtatshmërinë e vendit për palët dhe tribunalin.

17.2. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, dhe nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të takohet në cilindo vend që e konsideron të përshtatshëm për mbajtjen e dëgjimit të palëve, t dëshmitarëve, ose të ekspertëve, mbajtjen e konsultimeve ndërmjet anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit dhe për shiqimin e sendeve ose dokumenteve.

*Neni 18***Fillimi i procedurës së arbitrazhit**

Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, procedura e arbitrazhit lidhur me një kontest të caktuar fillon në ditën kur kërkesa që kontesti t'i nënshtrohet arbitrazhit pranohet nga pala e paditur.

*Neni 19***Gjuha**

19.1. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit, menjëherë pas themelimit të tij, e përcakton gjuhën ose gjuhët të cilat do të përdoren gjatë procedurës së arbitrazhit. Marrëveshja ndërmjet palëve, respektivisht, vendimi i tribunalit vlejnë për të gjitha deklaratat dhe parashtresat me shkrim që dorëzohen nga palët, seancat e dëgjimit, si dhe vendimet ose kumtesat tjera të tribunalit të arbitrazhit.

19.2. Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që të gjitha dokumenteve të dorëzuara gjatë procedurës së arbitrazhit t'u bashkëngjitet një përkthim në gjuhën ose gjuhët për të cilat janë pajtuar palët ose të cilat i ka caktuar tribunali i arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit i pranon vetëm përkthimet e bëra nga një përkthyes i certifikuar ose i aprovuar nga gjykata.

*Neni 20***Padia, përgjigja në padi dhe kundër-padia**

20.1. Brenda afatit të dakorduar nga palët ose, në mungesë të një dakordimi të tillë, brenda afatit të caktuar nga tribunali i arbitrazhit, paditësi ka për detyrë të paraqesë padinë e tij dhe provat në të cilat mbështetet padia, dhe i padituri ka për detyrë të paraqesë përgjigjen në padi dhe provat në të cilat mbështetet ajo. Së bashku me padinë, përkatësisht, në përgjigjen në padi, palët mund t'i paraqesin të gjitha dokumentet tjera të cilat i konsiderojnë të nevojshme dhe përcaktojnë se cilat prova tjera do t'i paraqesin.

20.2. Nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, secila palë gjatë procedurës së arbitrazhit mund ta ndryshojë ose ta plotësojë padinë e vet, respektivisht përgjigjen e vet në padi, përveç nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se ndryshimet ose plotësimet janë të palejueshme për shkak se janë paraqitur me vonesë.

20.3. Së bashku me përgjigjen në padi, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës, kur tribunali i arbitrazhit, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, vendos se vonesa është e arsyeshme, i padituri mund të paraqesë kundër-padinë e cila mbështetet në të njëjtën kontratë ose në një kërkesë të bazuar në të njëjtën kontratë me qëllim të kompensimit të ndërsjellët të kërkesave. Paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni zbatohen përshtatshëm për kundër-paditë.

*Neni 21***Dëgjimi i palëve dhe procedura me shkrim**

21.1. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, tribunali i arbitrazhit vendosë se a do të mbahet seanca e dëgjimit ose procedura do të zhvillohet në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara, ose nëse do të kombinohen të dy këto procedura. Nëse palët nuk e kanë përjashtuar mbajtjen e seancave të dëgjimit, tribunali i arbitrazhit mbanë seancat e dëgjimit në një fazë të përshtatshme të procedurës, nëse një gjë e tillë kërkohet nga pala. Seancat e dëgjimit nuk janë publike, përveç nëse palët janë dakorduar ndryshe.

21.2. Palët duhet të informohen paraprakisht dhe në kohë të duhur në lidhje me çdo seancë të dëgjimit dhe çdo mbledhje të tribunalit të arbitrazhit e cila ka për qëllim nxjerrjen e provave.

21.3. Të gjitha deklaratat, dokumentet ose informatat e tjera të cilat njëra palë ia dorëzon tribunalit të arbitrazhit u dërgohen edhe të gjitha palëve tjera. Kjo vlen edhe për raportet e ekspertëve ose provave tjera në formë të shkruar në të cilat tribunali i arbitrazhit mund ta mbështesë vendimin e tij.

21.4. Tribunali i arbitrazhit bënë përgatitjen e përkthimeve të deklaratave gojore gjatë seancave të dëgjimit si dhe mbajtjen e procesverbalit gjatë seancës, nëse një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme nga tribunali i arbitrazhit duke marrë parasysh rrethanat e rastit, ose nëse palët janë pajtuar për këtë dhe e kanë njoftuar tribunalin e arbitrazhit së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës së dëgjimit. Palët i bartin shpenzimet e përkthimit.

Neni 22

Mbyllja e seancës së dëgjimit

22.1. Pas paraqitjes së provave sipas nenit 20, paragrafi 1, tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët se a kanë për të paraqitur prova shtesë ose dëshmitarë plotësues. Nëse nuk ka paraqitje të tilla, seanca e dëgjimit mbyllet.

22.2. Me iniciativë të vetën, ose në bazë të kërkesës së njëres palë, tribunali i arbitrazhit mundet, në raste të jashtëzakonshme dhe kur këtë e konsideron të domosdoshme, ta caktojë rihapjen e seancës së dëgjimit në çdo kohë para marrjes së vendimit merititor.

Neni 23

Provat

23.1. Secila palë e ka barrën e të provuarit për faktet të cilat e mbështesin padinë, përkatësisht, përgjigjen në padi.

23.2. Tribunali i arbitrazhit përcakton pranueshmërinë, relevancën, vërtetësinë dhe peshën e provave të paraqitura.

23.3. Tribunali i arbitrazhit vendos mbi pranimin ose hedhjen poshtë të kërkesave për nxjerrjen e provave. Tribunali i arbitrazhit mund të nxjerrë prova, nëse këtë e konsideron të nevojshme, dhe bënë vlerësimin tyre në mënyrë të lirë dhe të paanshme.

23.4. Në çdo kohë gjatë procedurës, tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të paraqesin dokumente ose prova tjera brenda afatit të caktuar nga ai.

Neni 24

Dëshmitarët

24.1. Nëse duhet të dëgjohet një dëshmitar, së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës së dëgjimit, secila palë duhet t'ia dorëzojë tribunalit të arbitrazhit dhe palës tjetër emrin edhe adresën e dëshmitarit të cilin e fton të deklarohet, çështjen për të cilën do të dëshmojë dhe gjuhën në të cilën do ta paraqes dëshminë.

24.2. Deklaratat e dëshmitarëve mund të paraqiten edhe në formë të deklaratave të shkruara, të nënshkuara nga dëshmitari, me kusht që dëshmitari të jetë në dispozicion për palët, nëse njëra palë e kërkon ekzaminimin e dëshmitarit.

Neni 25

Ekspertët

25.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit mund të emërojë një ose më shumë ekspertë të cilët do t'i raportojnë atij me shkrim për çështje të caktuara nga tribunali i arbitrazhit.

25.2. Tribunali i arbitrazhit mund ta urdhërojë një palë që ekspertit t'i jep çdo informatë të nevojshme, të përgatisë ose t'i ofrojë qasje në dokumente ose sende për shiqim. Pas pranimin të raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit ua dërgon palëve nga një kopje të raportit me ç'rast palëve u jepet mundësia që me shkrim ta shprehin mendimin e tyre lidhur me raportin.

25.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, me kërkesë të palës ose nëse tribunali i arbitrazhit këtë e konsideron të nevojshme, eksperti, pasi të ketë dorëzuar raportin me shkrim, dëgjohet në seancë, gjatë së cilës palët kanë mundësi ta marrin ekspertin në pyetje. Gjatë kësaj seance të dëgjimit, palët mund të paraqesin ekspertët e tyre për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me çështjet e ngritura.

*Neni 26***Mosveprimi i palës**

26.1. Nëse paditësi nuk e paraqet padinë e tij në pajtim me nenin 20, paragrafi 1 dhe nuk ka arsyetim të mjaftueshëm për këtë, tribunali i arbitrazhit e mbyllë procedurën e arbitrazhit.

26.2. Nëse i padituri nuk e paraqet përgjigjen e tij në padi sipas nenit 20, paragrafi 1, tribunali i arbitrazhit vazhdon me procedurën. Mungesa e paraqitjes së përgjigjes në padi nga i padituri nuk do të konsiderohet si pranim i pretendimeve të paditësit.

26.3. Nëse njëra palë, edhe pse ka qenë e njoftuar me rregull sipas këtij ligji, nuk merr pjesë në seancën e dëgjimit ose nuk i dorëzon provat brenda afatit të caktuar, tribunali i arbitrazhit mund ta vazhdojë procedurën e arbitrazhit dhe ta nxjerrë vendimin në bazë të provave me të cilat disponon.

*Neni 27***Heqja dorë nga kundërshtimi**

Pala e cila është në dijeni për një shkelje të ndonjë dispozite të këtij ligji ose të marrëveshjes me palën tjetër por e cila prapseprapë vazhdon procedurën e arbitrazhit pa kundërshtuar menjëherë shkeljen në fjalë, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të parashtruar kundërshtimin.

*Neni 28***Ndihma e gjykatës**

28.1. Tribunali i arbitrazhit, ose pala që ka marrë miratimin paraprak nga tribunali i arbitrazhit, mund të kërkojë ndihmë nga gjykata, me qëllim të nxjerrjes së provave ose për kryerjen e punëve tjera juridike të cilat tribunali i arbitrazhit nuk është kompetent për t'i kryer.

28.2. Nëse gjykata konstaton se kërkesa e tillë është e pranueshme, ajo e zbaton kërkesën në pajtim me rregullat e saja procedurale.

Kreu VI**VENDIMET***Neni 29***E drejta kompetente**

29.1. Në rastet me element ndërkombëtar, tribunali i arbitrazhit zbaton të drejtën të cilën palët e kanë caktuar si të drejtën kompetente për aspektet materiale të kontestit. Në mungesë të një caktimi të tillë nga palët, tribunali i arbitrazhit zbaton të drejtën e përcaktuar nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare private. Në të gjitha rastet tjera, tribunali i arbitrazhit e zbaton legjisllacionin e Kosovës.

29.2. Tribunali vendos ex aequo et bono ose si amiable compositeur vetëm nëse palët shprehimisht e kanë autorizuar për këtë.

29.3. Në të gjitha rastet, tribunali i arbitrazhit vendos në pajtim me dispozitat e kontratës duke marrë parasysh uzancat tregtare që vlejné për rastin konkret.

*Neni 30***Marrja e vendimeve**

30.1. Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i tribunalit të arbitrazhit merret me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe.

30.2. Për çështjet procedurale drejtuesi i tribunalit të arbitrazhit vendos vet, nëse për këtë është i autorizuar nga palët ose nga të gjithë anëtarët e tribunalit të arbitrazhit.

*Neni 31***Forma dhe përmbajtja e vendimit**

31.1. Vendimi i tribunalit të arbitrazhit nxirret në formë të shkruar dhe është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Vendimi për palët e ka efektin e njëjtë juridik sikurse një aktgjykim i plotfuqishëm dhe detyrues i gjykatës.

31.2. Në vendim ceken arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar që arsyet të mos ceken.

31.3. Vendimi nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat, dhe mbanë datën dhe vendin kur është nxjerrë. Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, nënshkrimet e shumicës së anëtarëve të tribunalit janë të mjaftueshme, me kusht që në vendim të shpjegohen arsyet për mungesën e nënshkrimeve të tjera.

31.4. Nga një kopje e vendimit të nënshkruar nga arbitrat u dorëzohet të dyja palëve, pasi që të jenë paguar të gjitha taksat.

31.5. Vendimi bëhet publik vetëm me pëlqimin e të gjitha palëve.

*Neni 32***Pajtimi**

32.1. Nëse para nxjerrjes së vendimit palët pajtohen për zgjidhjen e kontestit, tribunali e ndërpre në procedurën e arbitrazhit.

32.2. Nëse kërkohet nga palët, tribunali i arbitrazhit mund të dokumentojë pajtimin e palëve në formë të një vendimi të arbitrazhit sipas kushteve për të cilat janë pajtuar palët, përveç nëse përmbajtja e pajtimit cenon ose është në kundërshtim me rendin publik (ordre public). Vendimi i tillë e ka efektin e njëjtë sikur një vendim meritohet.

*Neni 33***Përfundimi i procedurës së arbitrazhit**

33.1. Procedura e arbitrazhit përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar ose të një urdhri të tribunalit të arbitrazhit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

33.2. Tribunali i arbitrazhit nxjerr urdhër për ndërprerjen e procedurës së arbitrazhit nëse:

1. paditësi:

- a) nuk e dorëzon padinë e tij sipas nenit 20, paragrafi 1;
- b) e tërheq padinë, përveç nëse i padituri e kundërshton këtë dhe tribunali i arbitrazhit konstaton se i padituri ka interes legjitim që të nxirret vendimi përfundimtar mbi kontestin;

2. palët pajtohen për përfundimin e procedurës; ose

3. palët nuk vazhdojnë procedurën e arbitrazhit edhe pse vazhdimi i procedurës është kërkuar nga tribunali i arbitrazhit ose nëse vazhdimi i procedurës së arbitrazhit është bërë i pamundshëm ose i panevojshëm për arsye të tjera.

33.3. Mandati i tribunalit të arbitrazhit përfundon me ndërprerjen e procedurës, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

*Neni 34***Shpenzimet e procedurës**

34.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit cakton shpenzimet në vendimin e tij përfundimtar. Shpenzimet në fjalë përfshijnë:

- a. taksën e tribunalit të arbitrazhit;
- b. shpenzimet e arbitrave;
- c. shpenzimet për ekspertë dhe ndihmën tjetër të cilën e ka kërkuar tribunali i arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;

- d. shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga tribunali i arbitrazhit;
- e. shpenzimet për përfaqësimin dhe ndihmën për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit, dhe vetëm deri në atë masë që tribunali i arbitrazhit e cakton të arsyeshëm; dhe
- f. të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës kur kjo bënë emërimin e arbitërve.

34.2. Taksat e tribunalit të arbitrazhit duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën e kontestit, kompleksitetin e lëndës, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rast se shfaqen mosmarrëveshje në lidhje me shumën e taksave që duhet paguar tribunalit të arbitrazhit, gjykata është kompetente që të vendosë mbi këtë çështje.

34.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës humbëse. Tribunali i arbitrazhit mund të ndajë shpenzimet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni ndërmjet palëve, nëse konstaton se një ndarje e tillë është e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e rastit.

Neni 35

Korrigjimi, interpretimi dhe plotësimi i vendimit

35.1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, brenda tridhjetë ditëve nga marrja e vendimit, secila palë, duke e njoftuar edhe palën tjetër, mund të kërkojë nga tribunali i arbitrazhit:

- a. ta interpretojë vendimin;
- b. ta korrigjojë ndonjë gabim në llogaritje, gabim shtypi ose çfarëdo gabimi tjetër të kësaj natyre; ose
- c. ta nxjerrë një vendim plotësues në lidhje me paditë e ngritura para tribunalit të arbitrazhit, por të cilat nuk janë përfshirë në vendimin përfundimtar.

35.2. Brenda tridhjetë ditëve nga dërgimi i vendimit, tribunali i arbitrazhit mund të bëjë korrigjime të tilla me iniciativë të vetën. Tribunali i arbitrazhit i bën korrigjimet ose jep interpretimin brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës për ta bërë këtë.

35.3. Nëse tribunali i arbitrazhit konsideron se kërkesa për nxjerrjen e vendimit plotësues është e arsyeshme dhe konsideron se vendimi plotësues mund të nxirret pa mbajtjen e seancës së dëgjimit ose nxjerrjes së provave, tribunali i arbitrazhit e plotëson vendimin brenda gjashtëdhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës. Neni 30 vlen përshtatshëmrisht edhe për vendimet plotësuese.

Kreu VII

PROCEDURA GJYQËSORE

Neni 36

Mjetet juridike

36.1. Në rastet e parapara në paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, secila palë mund të kërkojë nga gjykata që të anulohet një vendim të tribunalit të arbitrazhit.

36.2. Gjkata anulon vendimin e tribunalit nëse:

- a). Paditësi dëshmon se:
 - (i) njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka patur zotësinë për të vepruar;
 - (ii) marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunali i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;
 - (iii) paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e tij;
 - (iv) vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshinë çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të ekzekutohet;
 - (v) përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit; ose

b). Gjykata konstaton se:

(i) arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj; ose

(ii) ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public).

36.3. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, padia për anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit i dorëzohet gjykatës jo më vonë se nëntëdhjetë ditë pas pranimit të vendimit të tribunalit të arbitrazhit nga pala përkatëse.

36.4. Kur kërkohet anulimi i vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata mundet, nëse kjo është e arsyeshme, ta anulojë vendimin dhe t'ia kthejë lëndën tribunalit të arbitrazhit që ta iniciojë sërish procedurën e arbitrazhit ose që t'i merr ato veprime, të cilat sipas vlerësimit të tribunalit të arbitrazhit do të mënjanojnë arsyet për anulimin e vendimit.

Neni 37

Dispozitat e përgjithshme të procedurës

37.1. Gjykata vendos me aktvendim. Para nxjerrjes së aktvendimit Gjykata ka për detyrë ta dëgjojë palën kundërshtare.

37.2. Në rastin e ngritjes së padisë, sipas nenit 36, për anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata ka për detyrë t'i dëgjojë të gjitha palët.

37.3. Kundër aktvendimit të Gjykatës në rastet e parapara në nenin 36, paragrafi 2, lejohet ankesa. Për të gjitha aktvendimet tjera të nxjerra nga Gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa.

Kreu VIII

NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË TRIBUNALIT TË ARBITRAZHIT

Neni 38

Vendimet e arbitrazhit të nxjerra brenda Kosovës

38.1. Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata.

38.2. Kërkesa që vendimi i arbitrazhit të shpallet i ekzekutueshëm hidhet poshtë nëse Gjykata konstaton se ekzistojnë një ose më shumë arsye për anulimin e vendimit sipas nenit 36, paragrafi 2. Kërkesës për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit sipas këtij neni i bashkëngjitet vendimi i tribunalit të arbitrazhit ose një kopje e vërtetuar e tij.

Neni 39

Vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës

39.1. Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm sipas paragrafëve 2 deri 5 të këtij neni.

39.2. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi të arbitrazhit të nxjerrur jashtë Kosovës i paraqitet Gjykatës Ekonomike.

39.3. Kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pala e interesuar ia bashkëngjet:

a). origjinalin e vendimit ose një kopje të vërtetuar të vendimit;

b). origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar të saj; dhe

c). një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit të arbitrazhit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, nëse marrëveshja ose vendimi nuk është përpiluar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.

39.4. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit refuzohet në bazë të kërkesës së palës tjetër, nëse ajo dëshmon se:

- a). njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit, sipas së drejtës kompetente për atë marrëveshje, nuk ka pasur zotësi për të vepruar; ose nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk ka qenë e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas së drejtës në territorin ku është marrë vendimi;
- b). pala, ndaj së cilës kërkohet ekzekutimi i vendimit, nuk është njoftuar me rregull në lidhje me caktimin e një arbitri ose për procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e saj;
- c). vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje e për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshin çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të njihet dhe të ekzekutohet;
- d). përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në atë rast; dhe
- e). vendimi ende nuk është bërë i plotfuqishëm për palët, ose është shfuqizuar ose pezulluar nga një organ kompetent në territorin ku është nxjerrë vendimi, respektivisht sipas drejtës në bazë të së cilës është nxjerrë vendimi.

39.5. Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit refuzohet, nëse Gjykata konstaton se:

- a). sipas ligjit në fuqi në Kosovë, kontesti përkatës nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit, ose
- b). njohja ose ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do të ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Kosovës.

Kreu IX

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 40

Ligji në fuqi

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat e ligjit në fuqi të cilat nuk janë në pajtim me këtë ligj.

Neni 41

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi një muaj pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe pas shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

UNMIK/REG/ 2008/30

05.06.2008